

**RELACION**

**PËR**

**PROJEKTVENDIMIN**

**E KËSHILLIT TË MINISTRAVE**

**MIRATIMIN PLANIT TË VEPRIMIT 2023-2025 NË ZBATIM TË  
STRATEGJISË KUNDËR KRIMIT TË ORGANIZUAR DHE  
KRIMEVE TË RËNDA 2021-2025”**

**I. QËLLIMI I PROJEKTVENDIMIT DHE OBJEKTIVAT QË  
SYNOHEN TË ARRIHEN**

Projektvendimi i Këshillit të Ministrave synon miratimin e Planit të Veprimit 2023-2025 në zbatim të Strategjisë kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda 2021-2025, pas përfundimit të afatit të zbatimit të Planit të Veprimit 2021-2022. Ky plan veprimi shërben si një instrument për të bashkërenduar të gjithë aktorët e interesuar shtetërorë dhe joshtetërorë, si dhe partnerët ndërkombëtarë që ndihmojnë e mbështesin vendin tonë në luftën kundër krimit të organizuar dhe krimeve të rënda.

Qëllimi i këtij projektvendimi është bashkërendimi, koordinimi dhe harmonizimi i përpjekjeve e nismave të të gjithë institucioneve dhe agjencive ligjzbatuese në vend, rekomandimeve të partnerëve dhe organizmave ndërkombëtare që veprojnë në fushën e krimit të organizuar, duke krijuar kuadrin e nevojshëm për bashkëpunim ndërmjet të gjithë aktorëve, përmes roleve e përgjegjësi të tyre institucionale. Qëllimi i hartimit të këtij dokumenti është orientimi i politikave dhe forcimi i qasjes gjithëpërfshirëse në parandalimin e kultivimit dhe trafikimit të lëndëve narkotike, pastrimit të parave, trafikeve të paligjshme, krimit kibernetik, krimeve mjedisore, parandalimit të përfshirjes së të rinjve dhe grupeve vulnerabël në krim të organizuar, nxitjen e kalimit të pronave të konfiskuara në pronësi të qeverisjes vendore për t’u përdorur për qëllime sociale etj.

Plani i Ri i Veprimit synon reflektimin e përgjegjësive të strukturave, agjencive dhe institucioneve që kanë përgjegjësi në luftën kundër krimit të organizuar dhe krimeve të rënda, mbi nevojat, problematikat që shtrën situata aktuale e krimit të organizuar. Përmes këtij projektakti do të synohet gjithashtu edhe rritja e kapaciteteve hetimore, operacionale dhe e strukturave të posaçme në luftën kundër krimit të organizuar dhe krimeve të rënda, goditja e grupeve kriminale etj.

Dokumenti i Planit të Veprimit 2023-2025 është pasuruar me masa konkrete për realizimin e objektivave të Strategjisë kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda 2021-2025, si dhe përcaktimin e mekanizmave implementues dhe koordinues, për adresimin apo parandalimin në kohë të fenomeneve të paligjshme në fushën e krimit të organizuar.

## **II. VLERËSIMI I PROJEKTVENDIMIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE**

Plani i Veprimit përbën dokumentin më të rëndësishëm politik dhe strategjik të vendit në fushën e krimit të organizuar. Ky dokument është vazhdim i përpjekjeve dhe objektivave të parashikuara në Strategjinë kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda 2021-2025, të ndryshuar.

Miratimi i këtij projekt-akti është diktuar nga nevoja e përfundimit të afatit të zbatimit të Planit të Veprimit 2021-2022 të Strategjisë kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda 2021-2025, të ndryshuar.

Gjithashtu, ky projektakt është parashikuar në Programin e Përgjithshëm Analitik të Projektakteve të Ministrisë së Brendshme, që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave, për vitin 2022, në katërmujorin III.

Plani i Veprimit 2023-2025 është tërësisht në harmoni dhe në përputhje me objektivat strategjike të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian (SKZHIE III) 2021-2030, i cili është dokumenti kryesor strategjik kombëtar të zhvillimit të Shqipërisë dhe procesit të integritetit të saj në Bashkimin Evropian si dhe është në përmbushje të parashikimeve të Planit Kombëtar të Integritetit Evropian (PKIE) 2022-2024, kapitulli, 24, “Drejtësi, Liri dhe Siguri”, ndaj miratimi i këtij projektvendimi, do të plotësojë realizimin e angazhimeve të Ministrisë së Brendshme, si në nivel kombëtar dhe ashtu dhe në atë ndërkombëtar.

Ky dokument politik lidhet me Objektivin *16.a* të Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ) i cili promovon shoqëri paqësore dhe gjithëpërfshirëse për zhvillim të qëndrueshëm, forcimin e institucioneve përkatëse kombëtare, duke përfshirë bashkëpunimin ndërkombëtar, për ndërtimin e kapaciteteve në të gjitha nivelet, veçanërisht në vendet në zhvillim, për të parandaluar dhunën dhe për të luftuar terrorizmin dhe krimin.

### **III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME**

Ministria e Brendshme në bashkëpunim me institucionet e tjera e përfshira në Strategjinë kundër Krimin të Organizuar dhe Krimeve të Rënda 2021-2025, të ndryshuar në rolin e institucionit lider, ka hartuar Planin e Veprimit 2023-2025 të SKKOKR, dhe ka planifikuar masa konkrete për të parandaluar dhe luftuar krimin e organizuar dhe krimet e rënda.

Plani i Veprimit 2023-2025, parashikon masa që duhet të realizohen sipas afateve të përcaktuara në dokument, me qëllim realizimin e qëllimeve politike dhe objektivave specifike të parashikuara në Strategjinë kundër Krimin të Organizuar dhe Krimeve të Rënda 2021-2025, të ndryshuar.

Ky dokument ka si qëllim jetësimin dhe realizimin në kohë dhe më cilësi të 3 qëllimeve strategjike të SKKOKR 2021-2025, duke synuar uljen e kërcënimit dhe ndikimit të krimin të organizuar dhe krimeve të rënda, mbrojtjen e qytetarëve, institucioneve dhe ekonomisë, si dhe parandalimin e krimin të organizuar dhe krimeve të rënda, të cilat synohet të arrihen duke zbatuar masat nga institucionet përgjegjëse brenda afateve kohore të përcaktuara.

Plani i Veprimit 2023-2025 në zbatim të Strategjisë kundër Krimin të Organizuar dhe Krimeve të Rënda, i ndryshuar, synon arritjen e rezultateve nëpërmjet koordinimit me institucionet publike dhe agjencitë ligjzbatuese relevante në këtë fushë, më të mira të vendeve partnere, si dhe rekomandimet në procesin e integritimit evropian. Gjithashtu, synohet modernizimi i sistemeve dhe ndërlidhja e tyre, duke siguruar një shkëmbim të shpejtë në kohë të informacionit me agjencitë inteligjente dhe ato të hetimit në vend, por edhe me organizatat ndërkombëtare si INTERPOL, EUROPOL etj., për gjurmimin, hetimin dhe goditjen e grupeve kriminale.

Ndërkaq synohet përmbushja e rekomandimeve të progres-raporteve të Komisionit Evropian për zbatimin efektiv të Strategjisë kundër Krimin të Organizuar dhe Krimeve të Rënda. Gjithashtu, synohet reformimi i

Polici së Kriminale, ngritja e strukturave të qëndrueshme, ndërtimi i platformës online për shitjen e pasurive të konfiskuara, si dhe nxitja e kalimit të objekteve të konfiskuara në pronësi të njërive të qeverisjes vendore me qëllim përdorimin si qëllime sociale.

#### **IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTESHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR**

Projektvendimi i paraqitur është në harmoni me rendin juridik të brendshëm. Ai është në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe veçanërisht nenin 100 të saj, sipas të cilit ndër të tjera përcaktohet se, “*Këshilli i Ministrave merr vendime për përcaktimin e drejtiveve kryesore të politikës shtetërore*”, vendimin nr. 604, datë 20.10.2021 të Këshillit të Ministrave, “*Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Brendshme*”.

#### **V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKT-AKTET NORMATIVE)**

Ky projektvendim nuk përafrohet në vetvete një akt të legjislacionit të Bashkimit Evropian, por do të shërbejë si instrument për adresimin e rekomandimeve të Bashkimit Evropian për përafrimin me *acquis communautaire* për fushën e rendit dhe sigurisë publike.

#### **VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKT-AKTIT**

Plani i Veprimit 2023-2025 përmban 3 qëllime politike si më poshtë:

1. Ulja e kërcënimit dhe ndikimit të krimit të organizuar dhe krimeve të rënda;
2. Mbrojtja e qytetarëve, institucioneve dhe ekonomisë;
3. Rritja e forcës parandaluese ndaj kërcënimeve të krimit të organizuar dhe krimeve të rënda.

Qëllimi kryesor i këtij dokumenti është garantimi i një mjedisi të sigurt për zhvillimin e vendit dhe shoqërisë nga kërcënimet e krimit të organizuar dhe

krimeve të rënda, duke siguruar jetën e individit, sipërmarrjen e lirë dhe respektimin e ligjshmërisë në tërësi.

Plani i Veprimit përbëhet nga 3 drejtime kryesore, duke kombinuar masa goditëse, mbrojtëse dhe parandaluese kundër krimit të organizuar dhe krimeve të rënda. Këto drejtime mbështeten nga disa objektiva specifike dhe masa të përcaktuara për realizimin e tyre. Hartimi i Planit të Veprimit 2023-2025 është bërë në bashkëpunim të ngushtë dhe gjithëpërfshirës me institucionet që kanë kontribuar në hartimin e këtij dokumenti.

**Qëllimi i Politikës I** “*Ulja e kërcënimit dhe ndikimit të krimit të organizuar dhe krimeve të rënda*” përmban 7 objektiva specifike si më poshtë:

**Objektivi specifik 1.1:** Goditja e veprimtarive kriminale në fushën e narkotikëve.

**Objektivi specifik 1.2:** Goditja e trafikeve të paligjshme.

**Objektivi specifik 1.3:** Goditja e krimit ekonomik dhe pastrimit të parave.

**Objektivi specifik 1.4:** Hetimi, ndjekja penale dhe dënimi i drejtuesve dhe anëtarëve të strukturave kriminale.

**Objektivi specifik 1.5:** Forcimi i bashkëpunimit policor ndërkombëtar.

**Objektivi specifik 1.6:** Kapja e personave në kërkim ndërkombëtar.

**Objektivi specifik 1.7:** Forcimi i marrëdhënieve juridiksionale me autoritetet e huaja.

**Qëllimi i Politikës II** “*Mbrojtja e qytetarëve, institucioneve dhe ekonomisë*” përmban 3 objektiva specifike si më poshtë:

**Objektivi specifik 2.1:** Identifikimi dhe mbështetja e individëve në rrezik për t’ju nënshtruar shtrëngimit, dhunës dhe frikësimit nga krimi i organizuar.

**Objektivi specifik 2.2:** Rritja e profesionalizmit.

**Objektivi specifik 2.3:** Dobësimi i motivit financiar në përfshirje në krim të organizuar.

**Qëllimi i Politikës III** “*Rritja e forcës parandaluese ndaj kërcënimeve të krimit të organizuar dhe krimeve të rënda*” përmban 2 objektiva specifike si më poshtë:

**Objektivi specifik 3.1:** Realizimi i fushatave për rritjen e ndërgjegjësimit me përfshirjen e institucioneve qendrore dhe vendore, shoqërisë civile, biznesit, medias dhe aktorëve të tjerë për parandalimin e krimit të organizuar.

**Objektivi specifik 3.2:** Ofrimi dhe koordinimi i mbështetjes së brendshme/huaj për zona dhe komunitete vulnerabël.

Me qëllim realizimin e objektivave specifikë të këtij Plani 2023-2025 institucionet përgjegjëse që ngarkohen me detyrime do të ndërhyjnë në fushat e mëposhtme:

1. Kuadri ligjor rregullator;
2. Kuadri institucional;
3. Procedurat;
4. Burimet njerëzore dhe trajnimi;
5. Infrastruktura dhe Pajisjet.

Disa nga masat kryesore të parashikuara në Planin e Veprimit 2023-2025 në zbatim të Strategjisë Kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda 2021-2025, të ndryshuar, janë si më poshtë:

- Riorganizimi i Policisë Kriminale;
- Rritja e sekuestrimeve dhe konfiskimeve i pasurive që kanë prejardhje nga veprimtari kriminale, mbështetur në hetime cilësore të thelluara;
- Rritja e bashkëpunimit mes agjencive ligjzbatuese;
- Rritja e numrit të hetimeve proaktive dhe me metoda speciale të hetimit;
- Zgjerimi i qasjes në rrjetin SIENA të DPPPP dhe DPT;
- Rritja e bashkëpunimit me partnerët ndërkombëtarë si INTERPOL, EUROPOL etj.;
- Rritja e shkëmbimit të të dhënave me vendet anëtare të ENFAST, EUROPOL dhe INTERPOL;
- Aplikimi i njëkohshëm i hetimeve financiare paralele krahas hetimit penal për veprat penale të krimit të organizuar;
- Kryerja e një vlerësimi të detajuar mbi Sistemin e Paralajmrimin të Hershëm për shkëmbimin e informacionit për substancat e reja psikotrope;
- Ngritja e seksionit të përgjimit parandalues në BKH;
- Ngritja e një sistemi analize në BKH për vlerësimin e kërcënimeve në lidhje me krimin e organizuar dhe korrupsionin, në bashkëpunim me agjencitë e tjera ligj zbatuese;
- Ngritja e procesit për hartimin e një analize kombëtare për vlerësimin kombëtar të rrezikut në lidhje me krimin e organizuar;

- Nxitja e kalimit të objekteve të konfiskuara në pronësi të njësisve të qeverisjes vendore për përdorimin e tyre për qëllime sociale;
- Rritja e rasteve të hetimeve proaktive dhe hetimi i vazhdueshëm i rasteve korruptive nëpër burgje, si dhe i trajtimeve preferenciale të të burgosurve.

## **VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E KËTIJ AKTI**

Plani i Veprimit 2023-2025 të Strategjisë kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda, të ndryshuar 2021-2025 do të zbatohet nga ministritë e linjës, institucionet e pavarura të cilat kanë një rol të veçantë në çështjet e krimit të organizuar dhe krimeve të rënda, si dhe institucionet shtetërore në nivel qendror dhe vendor.

## **VIII. INSTITUCIONET DHE SUBJEKTET E TJERA QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKT-AKTIT**

Nisma për hartimin e këtij projekt-akti është ndërmarrë nga Ministria e Brendshme si institucion përgjegjës për fushën e rendit dhe sigurisë publike, bazuar kjo dhe në fushën e saj të përgjegjësisë të rregulluar me vendimin nr.604, datë 20.10.2021 “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Brendshme”.

Ministritë e linjës, institucione të tjera si Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave, Prokuroria e Përgjithshme, Drejtoria e Përgjithshme të Doganave, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve; Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore, Shërbimi Informativ i Shtetit, Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar etj., kanë dhënë kontributin e tyre për hartimin e Planit të Veprimit 2023-2025.

Projektvendimi dhe relacioni shoqërues do të përcillen nëpërmjet sistemit e-aktet pranë:

- Ministrisë së Drejtësisë;
- Ministrisë së Mbrojtjes;
- Ministrisë së Kulturës;
- Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë;
- Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë;
- Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural;
- Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;
- Ministria së Evropës dhe Punët e Jashtme;
- Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit.

Projektvendimi dhe relacioni shoqërues do të përcillen me shkresë zyrtare për mendim pranë:

- Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit;
- Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara;
- Prokurorisë së Përgjithshme;
- Strukturës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar;
- Byroja Kombëtare e Hetimit;
- Këshillit të Lartë Gjyqësor;
- Këshillit të Lartë të Prokurorisë;
- Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare;
- Autoritetit Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike;
- Bankës së Shqipërisë;
- Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave;
- Akademisë së Sigurisë;
- Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave;
- Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve;
- Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes;
- Shërbimit Informativ të Shtetit.
- Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm të Burgjeve;
- Drejtorisë së Përgjithshme e Burgjeve;
- Institutit Kombëtar të Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore;
- Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes;
- Policisë Ushtarake;
- Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit;
- Institutit të Shëndetit Publik;
- Agjencisë Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore.

## **IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE**

Efektet financiare përlogariten nga çdo institucion bazuar në implementimin e aktiviteteve të masave përkatëse që janë të parashikuara në Planin e Veprimit 2023-2025 të kësaj Strategjie. Efektet financiare përballohen nga buxhetet respektive vjetore të institucioneve të ngarkuara, si dhe me buxhetim nga donatorë për zbatimin e Planit të Veprimit 2023-2025 të Strategjisë së Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda 2021-2025, të ndryshuar, në mënyrë të detajuar, si më poshtë:

<b>Monedha</b>	<b>Euro</b>	<b>Lekë</b>
----------------	-------------	-------------

Relacion shpjegues mbi projektvendimin “Për miratimin planit të veprimit 2023-2025 në zbatim të strategjisë kundër krimit të organizuar dhe krimeve të rënda 2021-2025”



<b>Kosto totale potenciale</b>	96,457,299	11,864,247,792
<b>Donatorët</b>	10,286,435	1,265,231,490
<b>Buxheti i shtetit</b>	86,170,864	10,599,016,302
<b>Hendeku financiar</b>	0	0

*\*Kursi mesatar për referencë është përlogaritur 125 Lekë për 1 Euro*

*\*Vlerat janë të shprehura në Euro dhe kundërvlera në Lekë*

**MINISTRI**

**BLEDAR ÇUÇI**